

VENDIM
Nr. 87, datë 7.6.2017

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA
NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për rinovimin e licencës për shoqërinë “Kurum International” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 69, datë 11.5.2017, filloi procedurën “Për rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a., në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike”.

Aplikimi i shoqërisë “Kurum International” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “a.1”, “b.1” dhe “c.1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Kurum International” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti